

VENDIM
Nr. 678, datë 16.10.2019

**PËR NJË SHITESË FONDESH, NË BUXHETIN E MIRATUAR PËR VITIN 2019,
PËR FINANCIMIN E AKTIVITETEVE QË DO TË ORGANIZOHEN ME RASTIN
E 75-VJETORIT TË ÇLIRIMIT TË VENDIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetet e institucioneve, për financimin e aktiviteteve që do të organizohen me rastin e 75-vjetorit të çlirimit të vendit, bëhen shtesat, si më poshtë vijojnë:

a) Ministrisë së Kulturës, në buxhetin e vitit 2019, i shtohen:

i. 15 120 000 (pesëmbëdhjetë milionë e njëqind e njëzet mijë) lekë në programin “Trashëgimia kulturore dhe muzetë”, në artikullin 604, për mbulimin e shpenzimeve për aktivitetet e organizuara nga Ministria e Kulturës dhe Bashkia Tiranë.

ii. 10 000 000 (dhjetë milionë) lekë në programin “Arti dhe kultura”, në artikullin 604, për mbulimin e shpenzimeve për aktivitetet e organizuara nga Ministria e Kulturës;

b) Ministrisë së Mbrojtjes, në buxhetin e vitit 2019, në programin “Planifikim menaxhimi administrimi”, në artikullin 604, i shtohet fondi 3 000 000 (tre milionë) lekë për mbulimin e shpenzimeve të kryera nga Organizata e Veteranëve të LANÇ-it;

c) Radiotelevizionit Shqiptar, në programin “Prodhome filmike ose veprimtari artistike mbarëkombëtare”, në artikullin 604, i shtohet fondi 2 000 000 (dy milionë) lekë për mbulimin e shpenzimeve për aktivitetet e organizuara në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë.

2. Fondet, sipas shkronjave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 1, në shumën e përgjithshme 30 120 000 (tridhjetë milionë e njëqind e njëzet mijë) lekë, të përballohen nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2019, sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Kulturës, Radiotelevizioni Shqiptar, Bashkia Tiranë dhe Organizata e Veteranëve të LANÇ-it për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

SHTOJCA NR. 1

Institucioni ku janë alokuar fondet	Shuma e akorduar në lekë	Institucioni përgjegjës për organizimin e aktiviteteve
Ministria e Kulturës	25 120 000	Ministria e Kulturës: shuma 15 620 000 lekë - Ekspozita “Shqipëria 75 vjet imazhe, 1944–2019” - Ekspozitë e hapur me fotografi të përmasave të mëdha në Tiranë - Ekspozitë “Rezistenca shqiptare gjatë Luftës II Botërore”, në hollin e MHK-së - Përkthim dhe botim i librit të Sir Anthony Quayle “Egiht hours from England”. Bashkia Tiranë: shuma 9 500 000 lekë

		- Riparimi i varreve në Varrezat e Dëshmorëve - Banderolat me portretet e dëshmorëve të LANÇ-it
Ministria e Mbrojtjes	3 000 000	Organizata e Veteranëve të LANÇ-it: 3 000 000 lekë - Zhvillimi i konferencës shkencore kombëtare/ndërkombëtare, me rastin e 75-vjetorit të çlirimit të Shqipërisë, sipas zërave: - shpenzime për të ftuarit (udhëtim, hotel, ushqim) - libri me kumtesat - honorare për kumtuesit - koktejl, darka - baneri, taksi, publicitet - kancelari për eventin
Radiotelevizioni Shqiptar (RTSH)	2 000 000	Radiotelevizioni Shqiptar: 2 000 000 lekë - Për organizimin e koncertit “Tinguj lufte” në bashkëpunim me Bashkinë Tiranë